



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

SCL-11-0006

Ankuesi

G. K etj,
Përfaqësuar nga **B. S Prizren.**

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 28 korrik 2020, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- HEDHET POSHTË si e pa pranueshme, Ankesa kundër Vendimit të Komisionit të Likuidimit të AKP-së, PRZ029-0068 i datës 24 dhjetor 2010.**
- Nuk caktohet taksë gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 28 mars 2011, B. S, në emër të 92 punëtorëve parashtror ankesë kundër Vendimit të Komisionit të Likuidimit nr. PRZ029-0068 të datës 24 dhjetor 2010, me të cilin ishte refuzuar kërkesa kolektive, për kompensim për paga të pa paguara, në shumë prej 623,254.92 € nga NSH “K” (në likuidim). Ankuesi nuk i ka specifikuar shkaqet e kundërshtimit të vendimit të Komisionit të Likuidimit, por në mënyrë të përgjithësuar e ka kundërshtuar procesin e privatizimit të ndërmarrjeve në Kosovë, duke bashkangjitur faqe të gazetave në të cilat flitet për AKP.

Me 20 shkurt 2020, gjykata lëshoj për ankuesin B. S urdhër me vërejtje për të parashtruar adresën e vendbanimit të ankuesit G K, në kuptim të nenit 32.1 dhe 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, pasi që ankuesi mund ta përfaqësojë vetveten në këtë procedurë kontestimore, apo mund të përfaqësohet nga një anëtar u Odës së Avokatëve të Kosovës, por nuk mund të përfaqësohet nga një person fizik, si është në rastin konkret B S. Gjykata e ka njoftuar ankuesin se nëse nuk e

dorëzon adresën e ankuesit G. K, brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të hedhet poshtë mbi bazë të pa pranueshmërisë konform nenit 36.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme

Arsyvetimi ligjor

Ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e papranueshme.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për Dhomën e Posaçme) gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Sipas nenit 32.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme parashihet që:

Secili paditës dhe i paditur përfaqësohet nga një anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, përveç Agjencisë, e cila pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përfaqësohet nga personat e autorizuar nga Agjencia, nga radhët e saj ose persona të tjerë të angazhuar. Person i punësuar apo i angazhuar nga Agjencia në kuptim të këtij neni përfshin edhe zyrtarët e emëruar nga Agjencia sipas nenit 14 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo çfarëdo legjislacioni pasardhës të tij.

Sipas nenit 32.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme parashihet që:

Pa marrë parasysh dispozitën më lart, personat fizikë mund të lejohen të përfaqësojnë vetveten, përveç nëse Gjyqtari i vetëm apo Kryesuesi i Kolegjit nxjerr një urdhër sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Sipas nenit 33.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme parashihet që:

Origjinali i çdo parashtrëse duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues të autorizuar...

Në interpretim të dispozitave të lartcekura, gjykata konstaton se personat fizik mund të iniciojnë procedurë pranë Dhomës së Posaçme dhe të parashetrojnë kërkesa të ndryshme, po ashtu lejohen që palët të përfaqësojnë vetveten, në të kundërtën, palët/ankuesi duhet të përfaqësohet nga një anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, por asesi nuk lejohet që palët të përfaqësohen nga personi fizik. Në rastin, konkret gjykata vlerëson se ankesa është e pa pranueshme, pasi që është parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit, i cili është person fizik dhe nuk është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, nuk lejohet që personi fizik BS të përfaqësojë ankuesin në Dhomën e Posaçme dhe të parashetrojë kërkesa në emër të tij.

Megjithatë, gjykata i ofroi edhe një mundësi ankuesit për ta plotësuar këtë kusht të pranueshmerisë, ashtu që nëpërmjet urdhrit të saj të datës 20 shkurt 2020, i kërkoi parashtrimin e adresës për ankuesin G K, brenda afatit të përcaktuar në atë urdhër. Nga

zyrtari i postës është konstatuar se urdhri është pranuar nga ankuesi Bajram Santuri, me 25 shkurt 2020.

Pra, meqenëse ankuesi dështoi në përmbushjen e kërkesës sipas urdhrit të gjykatës për të dorëzuar adresën e vendbanimit të ankuesit G K, thjesht duke mos e u përgjigjur në urdhrin e gjykatës, kjo e fundit vendosi të hedh poshtë ankesën e tij si të papranueshme.

Në pajtim me nenet 32, 33 dhe 36.2.5 dhe 36.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, kërkesa për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, hedhet poshtë si e papranueshme.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare
Hajrie Shala